



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 22.04.2016

Ref.: 240/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 41-të, të mbajtur më 14 prill 2016, mori:

V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa nr. 190/16, datë 13.04.2016 e Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", për akreditim të programeve të studimit:

- Edukim Parafillor, BA (240 ECTS);
- Matematikë, MSc, (120 ECTS);
- Edukim Parafillor në Gjuhë Boshnjake, BA (240 ECTS);
- Edukim Parafillor në Gjuhë Turke, BA (240 ECTS);
- Edukim Fillor në Gjuhë Boshnjake, BA (240 ECTS);
- Edukim Fillor në Gjuhë Turke, BA (240 ECTS);
- Teknologji Informative dhe Telekomunikimi në Gjuhë Boshnjake, BSc (240 ECTS)
- Teknologji Informative dhe Telekomunikim në Gjuhë Turke, BSc (240 ECTS)

A r s y e t i m i

Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", ka parashtruar kërkesë pran Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit: Edukim Parafillor, BA (240 ECTS); Matematikë, MSc, (120 ECTS); Edukim Parafillor në Gjuhë Boshnjake, BA (240 ECTS); Edukim Parafillor në Gjuhë Turke, BA (240 ECTS); Edukim Fillor në Gjuhë Boshnjake, BA (240 ECTS); Edukim Fillor në Gjuhë Turke, BA (240 ECTS); Teknologji Informative dhe Telekomunikimi në Gjuhë Boshnjake, BSc (240 ECTS) Teknologji Informative dhe Telekomunikim në Gjuhë Turke, BSc (240 ECTS).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 14 prill 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", dhe pas shqyrtimit të dosjes së stafit akademik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2013, datë: 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, dhe në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.02/2013, datë: 16.01.2013, KSHC ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti".

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të ofruar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", KSHC konstatoj se ka mungesë të stafit akademik me dokumentacion të rregullt për këto programe te studimit me të cilat ka aplikuar për ri-akreditim, dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje, KSHC mori vendim për refuzim të aplikacionit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" për programet e cekura më sipër.

Edhe për kundër mundësisë së dhen nga AKA (njoftimin përmes e-mailit datë: 01.12.2015) për plotësimin e dosjes së stafit akademik nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", për programet e cekura më sipër, ky i fundit nuk ka përmbushur kriteret sipas nenit 11. pika 3.2 e Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.02/2013.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti";
- Arkivit të AKA-së.


Prof Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

